

STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ICE LAVANDERI” SH.P.K

Në zbatim të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” dhe ligjit ne fuqi ne Republiken e Shqiperise ,themeluesit:

- 1- **Z. Eduard Strugaj** lindur më dt 23.10.1979 ne Lajthize,Puke , banor në Tirane, Rruga Kongresi Manastirit ,Apartamenti 46/9,Tirane, shtetas Shqiptar ,identifikuar me karte identiteti nr.H91023019F, madhore e me zotësi të plotë Juridike për të vepruar.

- 2- **Z. Nikolin Pali** lindur më dt 05.06.1981 ne Fierze,Puke , banor në Tirane, Rruga Avdyl Matoshi ,banesa private nr 54,Tirane, shtetas Shqiptar ,identifikuar me karte identiteti nr.I10605075D ,madhore e me zotësi të plotë Juridike për të vepruar.

- 3- **Z. Gerti Hysaj** lindur më dt 24.06.1991 ne Lepenice,Vlore , banor në Tirane, Rruga Fortuzi,Ndertesha nr 12,Hyrja 1,Apartamenti1 ,Tirane, shtetas Shqiptar ,identifikuar me karte identiteti nr.J10624115R, madhore e me zotësi të plotë Juridike për të vepruar.

Vendosen sote date 20.02.2024 per themelimin e kompanise **“ICE LAVANDERI” SH.P.K.**

KREU I



Emërtimi-Forma ligjore- Objekti
Selia- Afati-Vula

Neni 1

Shoqëria do te mbaj emërin **“ICE LAVANDERI” Shpk** ,dhe emer tregetar **“ICE LAVANDERI” Sh.p.k..**

Emërtimi i shoqërisë do të shfaqet në të gjitha aktet që do të dalin në emër dhe për llogari të shoqërisë.

Neni 2 – Forma ligjore



Kompania është një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, në bazë të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" shoqëria mund të konvertohet në një formë tjetër me vendim të themeluesve të saj.

Neni 3 - Objekti

Shoqëria ka si objekt të aktivitetit të saj :

Lavanderi industriale, pastrim kimik dhe shërbime të tjera pastrimi. Import-eksport, tregtim me shumicë e pakicë detergjentesh, materialesh dhe stoffe të ndryshme, lavanderi profesionale dhe shërbime të ngjashme. Larje, tharje, hekurosje, paketim, ngjyrosje, lyerje dhe konfeksionime të ndryshme për çdo lloj tekstili. Import export të materialeve që lidhen me fushën e lavanderive dhe konfeksionimeve. Import export makinerish që lidhen me fushën e shërbimeve të konfeksionimeve dhe lavanderive industriale. Dhenie me qira apo në përdorim të materialeve për restorante, hotele, etj. Mirembajtje dhe pastrim dhomash (service solution). Çdo lloj shërbimi tjetër që ka lidhje me aktivitetin kryesor.

Neni 4 - Selia

Selia ligjore e Shoqërisë është në Vlorë , Rruga Mehmet Alemi, pasuria nr 3831/1, zona kadastrale 3621, Tragjas , Vlorë.

Asambleja e shoqërisë ka të drejtë të hap seli të tjera dytësore, filiale, zyra përfaqësimi dhe seli prodhimi si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, madje të transferojë Selinë e Shoqërisë, por kjo e fundit do të mbetet gjithësesi në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 5 - Kohëzgjatja e veprimtarisë

Aktiviteti i Shoqërisë do të fillojë në datën e regjistrimit të tij në QKB. Kohëzgjatja e veprimtarisë së kësaj Shoqërie është me afat të përcaktuar, por shoqëria mund të shpërbëhet në çdo moment me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 6-Vula

Shoqëria do të ketë vullnet të saj me të drejtë përdorimi nga administratori i saj. Forma e vullnetit dhe madhësia e saj do të përcaktohen nga ortakët themelues në përputhje me kërkesat përkatëse ligjore në Shqipëri.

KREU II

KAPITELI THEMELTAR DHE KUOTAT

Neni 7 -Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 150,000 (njeqind e pesedhjetmije) leke dhe mund të rritet në bazë të modaliteteve ligjore.

Neni 8 – Vlera e kuotave dhe pjesëmarrja

Kapitali themeltar i Shoqërisë përbëhet nga 3 (tre) kuote, të mbajtuara nga ortakët e Shoqërisë Si me poshte:

Z. **Eduard Strugaj** mbajtës i 1 (një) kuote, baraz me 33% të kapitalit me vlerë nominale prej 49,500 leke.

Z. **Gerti Hysaj** mbajtës i 1 (një) kuote, baraz me 33% të kapitalit me vlerë nominale prej 49,500 leke.

Z. **Nikolin Pali** mbajtës i 1 (një) kuote, baraz me 34% të kapitalit me vlerë nominale prej 51,000 leke.

Neni 9 – Trasferimi i kuotave


Kuotat e kapitalit janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve. Trasferimi i kuotave ndaj të tretëve- jo ortakë, do t'i nënshtrohet respektimit të së drejtës së parablerjes. E drejta e parablerjes i përket cdo ortaku, në proporcion me kuotat e mbajtura dhe duhet të ushtrohet Brenda 30 ditëve kalendarike nga oferta e njoftuar nga ortaku që ka vullnetin për shitjen e kuotave. Oferta duhet të njoftohet me postë të regjistruar dhe marrja e njoftimit duhet të jetë konfirmuar.

Në rast mosekzekutimi të së drejtës së parablerjes brenda 30 ditëve kalendarike nga marrja e njoftimit për ofertën e shtjes, kuotat mund t'i transferohen palëve të treta.

Neni 10 – Zvogelimi apo rritja e kapitalit

Ortakët mund të rrisin ose zvogelojnë kontributet e tyre në kapitalin themeltar vetëm me vendim të ortakëve të saj, në masën e lejuar nga ligji, përndryshe kompania duhet të ndryshoj formën e vet ligjore.

Neni 11 – Financimet



Financimet e bëra nga ortakët, në proporcion me kuotat e mbajtura dhe në përputhje me vendimet e asamblesë, janë të lira nga interesat.

KREU III

ASAMBLEJA, ADMINISTRATORI DHE EKSPERTI KONTABEL

Neni 12 – Asambleja e Ortakëve dhe kompetencat e saj

12.1 Organi vendimmarrës i Shoqërisë është Asambleja e Ortakëve.

12.2 Vendimet e Asamblesë së Shoqërisë për të cilat kërkohet një shumicë e thjeshtë, janë të vlefshme nëse në mbledhje janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë më shumë se 50 (pesëdhjetë) % të të gjithë kapitalit themeltar dhe asambleja do të vendosë me votën e ortakëve që përfaqësojnë më shumë se 50 (pesëdhjetë) % të kapitalit themeltar.

12.3 Vendimet e Asamblesë së Shoqërisë për të cilat kërkohet një shumicëe kualifikuar, janë të vlefshme nëse, si në mbledhjen e parë ashtu edhe në mbledhjen e dytë janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të paktën $\frac{3}{4}$ e të gjithë kapitalit themeltar dhe Asambleja do të vendos si në mbledhjen e parë ashtu edhe në mbledhjen e dytë me votën e ortakëve që përfaqësojnë $\frac{3}{4}$ e kapitalit themeltar.

Jane competence vetem e asamblese se shoqerise detyrat si vijone:

- Percaktimi i palitikave tregetare te shoqerise
- Te ndryshoj nenet e ketij statusi
- Emerimin apo shkarkimin e administratorit
- Emerimin apo shkarkimin e auditoreve
- Percaktimin e pages apo shperbilimeve te administratorit dhe audituesit
- Te ndryshoj selin e shoqerise
- Te ndryshoj emrin e shoqerise
- Rritje ose zvogelimin e kapitalit te soqerise
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise
- Miratimin e rregullores se punes per mbarvajtjen e shoqerise
- Ceshtje te tjera qe kerkohen me ligj ose status

Neni 13 – E drejta e pjesëmarrjes së votës

13.1 Cdo ortak katë drejtë të marr pjesë në Asamble dhe të paraqes mendimin e tij dhe të jap po aq vota sa është numri i kuotave të kapitalit që ai zotëron.

13.2 Cdo ortak katëdrejtë të përfaqësohet nga një person tjetër jo ortak, i pajisur me prokurë me shkrim, me anën e së cilës do të japë votën e tij.

13.3 Ortaku nuk mund të lëshoj prokurë për votim për një pjesë të kuotave të kapitalit që ai zotëron, në qoftë se voton personalisht për pjesën e mbetur të kuotave.

Neni 14 – Thirrja e Asamblesë së Ortakëve

14.1 Asambleja e Ortakëve thirret të paktën një herë në vit, Brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar, me qëllim miratimin e Bilancit, të Raportit të Administratorit, Ekspetit Kontabël si dhe Inventarit.

14.2 Asambleja mund të thirret në cdo moment nga një prej administratorëve ose nga një ose disa ortakë që përfaqësojnë më shumë se 5 (pesë) % të kapitalit themeltar.

14.3 Asambleja duhet të thirret nëpërmjet njoftimit me letër rekomande me kthim përgjigje që duhet t'u dërgohet ortakëve në adresën që rezulton në Librin e Ortakëve dhe Ekspetit Kontabël, nëse është emëruar një i tillë, të paktën 7 (shtatë) dite kalendrike përpara mbledhjes së Asamblesë. Thirrja duhet të përmbaj informacion mbi llojin e Asamblesë, si dhe çështjejt që do të trajtohen dhe për të cilat do të duhet të merret vendim, vendin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë.

14.4 Asambleja mund të thirret dhe jashtë Selisë së Shoqërisë, në Shqipëri dhe jashtë saj.

14.5 Mbledhjet e Asamblesë mund të mbahen edhe nëpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe t'u lejohet të ndjekin diskutimin dhe të ndërhyjnë në momentin që duhet të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes. Asambleja konsiderohet në vendin ku ndodhet Kryetari dhe Sekretari i mbledhjes.

14.6 Asambleja do të thirret dhe mbahet rregullisht dhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit, në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të gjithë kapitalin themeltar.

14.7 Cdo Asamble do të drejtohet nga një ortak ose ndonjë person tjetër i caktuar nga e njëjta Asamble. Për pasqyrimin e vendimit, Asambleja emëron një sekretar, që mund të jetë edhe jo-ortak.

14.8 Vendimet e Asamblesë duhet të nënshkruhen nga Kryetari dhe Sekretari i Asamblesë.

Neni 15 – Administrimi

15.1 Shoqëria administrohet nga 1 (një) administrator, i cili qëndron në detyrë deri në revokim apo dorëheqje, për një periudhë maksimale prej 5 (pesë) vjetësh, me te drejten e rinovimit.

15.2 Përfaqësimi ligjor do ti besohet administratorit Z. **Gerti Hysaj**. Admonistratori do të ushroj të gjitha kompetencat sipas parashikimeve të nenit 95 të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 " Per Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare".

15.3 Administratori mund të emëroj përfaqësues të posaçëm për akte të vecanta ose kategori aktesh.

Neni 16 – Eksperti Kontabel I Autorizuar

16.1 Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e ortakëve, kontrolli i Pasqyrave Financiare dhe Librave Kontabël të Shoqërisë mund t'i besohet një eksperti kontabël të licensuar.

16.2 Eksperti Kontabel i licensuar mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

KREU IV VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPERNDARJA E FITIMEVE

Neni 17

17.1 Viti Financiar fillon me datë 1 Janar dhe mbaron në datë 31 Dhjetor të secilit vit kalendarik.

17.2 Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe përfundon më 31 Dhjetor të të njëjtit vit kalendarik.

17.3 Bilancet vjetore, Raportet e administratorit dhe ekspertit kontabel të autorizuar, nëse është emëruar, miratohen nga Asambleja e Ortakëve me shumicën e përcaktuar sipas ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare”.

17.4 Miratimi i dokumenteve që lidhen me Vitin Financiar duhet të bëhet Brenda 6 (gjashtë) muajve nga fundi i Vitit Financiar.

Neni 18 – Fitimet

18.1 Fitimet që rezultojnë nga Bilanci vjetor, duke zbritur 5 (pesë) % të destinuara për rezervën ligjore deri në 10 (dhjetë)% të kapitalit themeltar, dhe duke zbritur gjithashtu të gjitha shumat që Asambleja vendos të lër mënjanë, u shpërndahen ortakëve në proporcion me kuotat e kapitalit themeltar të zotëruara, pasi është paguar dividenti.

18.2 Asambleja mund të vendos dhe zbritje të veçanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo për shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.

KREU V SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

Neni 19 – Prishja

19.1 Shoqëria priset me Vendim të Asamblesë së Ortakëve, me shumicën e kërkuar për ndryshimet në Statut.

19.2 Shoqëria nuk priset në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, pazotësisë juridike, vdekjes ose falimentit të njërit ose disa ortakëve.

Neni 20 – Likuidimi

20.1 Në rast prishje, Shoqëria duhet të likujdohet.

20.2 Për të administruar këtë proces, Asambleja emëron një ose më shumë Likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare, mbi gjendjen e Aktiveve dhe Pasiveve të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për përfundimin e likuidimit.

20.3 Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja do të vendos mbi Bilancin Financiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga Likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.

20.4 Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do të shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit ortakëve në proporcion me kuotat e kapitalit themeltar të zotëruara prej tyre.

Neni 21 – Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

21.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti, si dhe ato që mund të lindin në pergjithësi midis ortakëve (përveç atyre personale dhe jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve të Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtëpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.


21.2 Në rast se nuk arrihet një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ato do të besohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 22 – Gjuha

22.1 Ky Statut ështëi përbërë nga 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe me vlerë të njëjtë ligjore


Lexuar, gjetur konform vullnetit të lirë e të pavarur, pranuar dhe nënshkruar nga ortakët themelues.

ORTAKET THEMELUES

Edmond Strugaj


GERTI HYSAN



Nikolin Pali

26